

**Prof. Asoc. Dr. Fatmira MUSAJ, Tafil BOLETINI: "Pranë Isa Boletinit", Kujtime 1, (1892-1916), Tetovë, 1996, f. 267.**

Me kujtimet e Tafil Boletinit jam njohur gjatë hulumtimeve në Arkivin Qendror të Shtetit, të cilat i kam shfrytëzuar gjatë hartimit të monografisë kushtuar njërës prej figurave të shquara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Isa Boletinit.

Përpunuesi i këtyre kujtimeve, prof. Marenglen Verli, ka bërë një punë serioze në përpunimin dhe redaktimin e tyre, duke ruajtur të paprekur mendimin e autorit, origjinalitetin gjuhësor të tij etj. Duke u mbështetur në kriteret shkencore që kërkon publikimi i gjinisë së kujtimeve të karakterit historik, kujtimet janë ndarë në dy vëllime. Vëllimi i parë titullohet "Pranë Isa Boletinit", që përfshin vitet e Rilindjes Kombëtare dhe vitet e para pas shpalljes së pavarësisë (1892-1916). Vëllimi i dytë titullohet "Përballë sfidave të kohës", Kujtime 2 (1916-1963).

Në vëllimin e parë, "Pranë Isa Boletinit", autori sjell të dhëna mjaft interesante dhe me vlerë historike për veprimtarinë e I. Boletinit në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, si dhe për rolin e tij në lëvizjen e armatosur kundër-osmane, në formimin e shtetit kombëtar, në luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Vëllimi përmban një parathënie të M. Verlit në të cilën përmbledhet jeta dhe veprimtaria e T. Boletinit. Në fillim ai qëndroi pranë I. Boletinit. Kjo kohë ndikoi në formimin e tij me virtytet më fisnike të një atdhetari të shquar. Në parathënie vihet në dukje se T. Boletini nga një i pranishëm i thjeshtë në ngjarjet e rëndësishme që kurorëzuan Rilindjen Kombëtare, gradualisht u shndërrua në një pjesëmarrës me peshë në veprimtaritë dhe në luftën për liri dhe pavarësi.

Pas parathënies autori thekson se në këto kujtime ai është udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe nga origjinaliteti, duke lënë mënjanë zbukurimet.

Në hyrje të Kujtimeve T. Boletini paraqet pemën e familjes së Boletinëve në 14 breza, si dhe vendbanimet e tyre, Isniqin, Istogun etj. Gjithashtu ai kujton se përballja e parë e familjes së tyre me pushtuesit osmanë është bërë në vitin 1750, tre breza para I. Boletinit.

Në pjesën e dytë të titulluar "I. Boletini deri në vitin 1912", T. Boletini evidenton përballjet e para të I. Boletinit në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, kundër përpjekjeve të Portës së Lartë për forcimin e administratës osmane në Kosovë. Krahas qëndresës antiosmane, T. Boletini sjell në kujtime shqetësimin e I. Boletinit dhe të atdhetarëve të tjerë për rezikun që i kanosej Kosovës dhe tërë Shqipërisë nga planet shoviniste të Beogradit. Aty shprehet qëndrimi i tij ndaj armatosjes së pakicave serbe nga Serbia, ndaj ndërhyrjeve të Rusisë në mbështetje të politikës së Beogradit dhe kundërshtimi që I. Boletini i bën çeljes së konsullatës ruse në Mitrovicë. Gjithashtu aty theksohet shqetësimi i Stambollit për rritjen e autoritetit të I. Boletinit në Kosovë dhe për qëndrimin e tij ndaj Rusisë dhe Serbisë.

Autori thekson se Porta e Lartë e pa të udhës ta tërhiqte I. Boletinin në Stamboll për të qetësuar fqinjin dhe Rusinë. Një nga kushtet që I. Boletini i paraqiti Portës së Lartë për të pranuar ftesën për të shkuar në takim me sulltanin ishte që të mos lejohej çelja e konsullatës ruse në Mitrovicë. Po sipas T. Boletinit, Porta e Lartë nuk e mbajti premtimin. Pas largimit të I. Boletinit në nëntor të vitit 1902 në Stamboll, në Mitrovicë u çel konsullata ruse, e cila u bë një nga shkaqet kryesore të kryengritjes së përgjithshme të vitit 1903, e cila përfundoi me vrasjen e konsullit rus Shçerbin. Megjithëse ishte 15 vjeç, i ndodhur midis kryengritësve rastësisht, T. Boletini përshkruan zhvillimin e kryengritjes, vendosmërinë e kryengritësve për ta çuar atë me çdo çmim deri në fund.

Pas kryengritjes së vitit 1903, T. Boletini shkon në Stamboll te axhai Isa. Atje ndoqi shkollën ushtarake. Qysh nga ky moment dhe deri në vitin 1916, Tafili nuk u nda nga I. Boletini. Prandaj kujtimet marrin karakter të dyfishtë: krahas të dhënave të rëndësishme për figurën e I. Boletinit dhe ngjarjeve madhore të historisë sonë kombëtare, në qëndrimet dhe mendimet e tij është i pranishëm dhe aktiv edhe T. Boletini.

Autori përshkruan jetën e I. Boletinit në Stamboll, ku ai qëndroi për afër 4 vjet. Pas kthimit në atdhe, në vitin 1906, autori sjell të dhëna për përkrahjen që Isai i dha revolucionit xhonturk për rrëzimin e sulltan Hamitit dhe rishpalljen e Kushtetutës së vitit 1878. Aty vihet në dukje roli i I. Boletinit në organizimin e Kuvendit të Ferizajt dhe rëndësia që ai pati në shpalljen e Kushtetutës së vitit 1878. Megjithëse mbështeti lëvizjen xhonturke, kujton T. Boletini, Isai asnjëherë nuk iu përgjigj thirrjes për t'u bërë anëtar i partisë së tyre dhe të luftonte për të zbatuar programin e kësaj lëvizjeje. Për ta bindur, kujton autori, Isai iu ofruan grada dhe para, si dhe iu bënë trysni të ndryshme. Kur e panë se ai nuk u thye, në nëntor të vitit 1908 dërguan ushtrinë për ta eliminuar, por nuk ia arritën qëllimit.

Vend të rëndësishëm në kujtime zënë kryengritjet e mëdha antiosmane të viteve 1910-1912. Të dhëna të shumta dhe të përshkruara në mënyrë mjaft tërheqëse japin rolin dhe përkushtimin e I. Boletinit në këto kryengritje. Aftësitë e I. Boletinit aty zbulohen në disa linja, në fushën e organizimit, të drejtimit dhe të udhëheqjes së veprimeve luftarake. Ai merr pjesë në të gjitha kuvendet ku shpreh qëndrimin e tij pro programit autonomist të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Si dëshmitar pamor, T. Boletini në këto kujtime thekson qëndrimin e vendosur deri në fund të I. Boletinit ndaj programit autonomist të Kuvendit të Junikut si dhe përjashton çdo lëkundje të tij ndaj këtij programi.

Në pjesën e tretë autori sjell kujtime për qëndresën e I. Boletinit dhe të udhëheqësve të tjerë kosovarë kundër mësymjes serbe dhe të ushtrive të tjera të Aleancës Ballkanike. Në pamundësi për të bërë një qëndresë të gjatë ndaj ushtrive të organizuara e të armatosura dhe i dënuar me vdekje prej tyre, autori tregon vendimin e I. Boletinit për t'u tërhequr drejt Shqipërisë. Ai përshkruan rrugën që ndoqi Isai në drejtim të Vlorës për të marrë pjesë si delegat i Kosovës në Kuvendin Kombëtar për shpalljen e pavarësisë, pritjen e ngrohtë që i bëri I. Boletinit populli i Vlorës dhe personalitetet politike si I. Qemali, Luigj Gurakuqi etj. Deri në vitin 1914 I. Boletini qëndroi në Vlorë ku u angazhua në mbrojtje të qeverisë së re. Ai

mori pjesë në delegacionin që qeveria e Vlorës çoi në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, ku dha ndihmesën e tij në mbrojtje të tërësisë tokësore të vendit.

Në kujtimet e tij T. Boletini iu kushton një vend të rëndësishëm viteve 1913-1915, të cilat ishin vite mjaft të vështira për ekzistencën e qeverisë së Vlorës e të shtetit shqiptar. Të dhëna mjaft interesante autori sjell për gjendjen e krijuar si rezultat i politikës antikombëtare të Esad pashë Toptanit ndaj qeverisë së Vlorës, në luftë për mbrojtjen e Shkodrës. Në këto situata të rënda të krijuara për Shqipërinë, I. Boletini dhe kosovarët të tjerë u përpoqën për organizimin e kryengritjes së vitit 1913 për çlirimin e bashkimit të trojeve shqiptare të pushtuara. Ndërkohë gjendja në qeverinë e Vlorës u përkeqësua dhe në janar të vitit 1914 ajo dha dorëheqjen. Në këto momente I. Boletini u kthye përsëri në Vlorë.

Kur Princ Vidi erdhi në krye të shtetit shqiptar Isai la Vlorën dhe u vu në mbrojtje të shtetit shqiptar. Autori përshkruan qëndrimin e I. Boletinit ndaj kryengritjes fshatare të Shqipërisë së Mesme, ndaj lëvizjeve të Esat pashë Toptanit si edhe ndaj përpjekjeve të Austro-Hungarisë për t'i tërhequr kosovarët në luftën botërore kundër Serbisë. Aty dalin në pah përpjekjet e I. Boletinit për të shfrytëzuar mosmarrëveshjet midis shteteve ndërluftuese për çlirimin e trojeve shqiptare të pushtuara.

Largimi i Princ Vedit në shtator të vitit 1914, thekson autori, ka qenë një moment mjaft i dhimbshëm për I. Boletinin, pasi ai e quante atë simbolin e shtetit shqiptar. Pas kësaj ai vendosi të lërë Durrësin e të hidhej përsëri në Kosovë. "Sa e ëmbël ishte ajo ditë e 28 nëntorit 1912, - thekson T. Boletini, - aq e hidhur ishte ajo e shtatorit 1914 për fatin e Shqipërisë".

Fundin e vitit 1914 dhe vitin 1915, I. Boletini i kaloi në Malësinë e Gjakovës, në Gash e Krasniqe, midis miqsh dhe shokësh, i sëmurë nga malarja. Megjithëse i sëmurë, kujton T. Boletini, Isai në bashkëpunim me B. Currin organizuan qëndresën malësore për t'i prerë hovin sulmit të ushtrisë malazeze në muajt qershor-korrik të vitit 1915, që pasi shkeli Malësinë e Gjakovës iu drejtua qytetit të Shkodrës. Pushtimi i qytetit e detyroi I. Boletinin t'i drejtohet përfaqësuesit të Francës, për ta ndihmuar që të kalonte në një vend asnjanes. Vendimi i tij për t'ia dorëzuar I. Boletinin Malit të Zi, kujton Tafili, e dëshpëroi pa masë axhën. Muajt e qëndrimit të I. Boletinit në Mal të Zi, Tafili i quan si internim dhe jep hollësi rreth përpjekjeve të qeverisë malazeze për ta zhdukur fizikisht I. Boletinin dhe të afërmit e tij që e shoqëronin. Duke i përshkruar ata muaj, autori jep fundin e jetës së Isait. I ndjekur këmba-këmbës nga forcat e xhandarmërisë malazeze, në janar të vitit 1916 ai u vra pabesisht prej tyre vetë i tetë tek ura e Ribnicës.

Krahas vlerës që paraqesin këto kujtime për veprimtarinë e I. Boletinit në Lëvizjen Kombëtare, ato sjellin mendimin e tij për probleme të ndryshme të luftës për liri, pavarësi dhe për bashkim kombëtar.

Autori sjell në kujtime shumë emra të njohur të Lëvizjes Kombëtare, me të cilët Isai u lidh dhe bashkëpunoi gjatë gjithë jetës së tij në shërbim të vendit, si edhe emra luftëtarësh të cilët u bënë pasuesit dhe mbështetësit e flaktë të I. Boletinit në kryengritjet e mëdha kundërosmane.

Kujtime 1 të Tafil Boletinit janë shkruar thjeshtë dhe qartë. Një pjesë e mirë e tyre përkon me të dhënat dokumentare, çka u jep vërtetësi historike. Ky botim do t'u vlejë historianëve, studentëve, si edhe lexuesve të thjeshtë që duan të dinë për Isa Boletinin dhe ndihmesën e tij në Lëvizjen Kombëtare, si edhe për shoqëruesin, nipin e tij, T. Boletinin, i cili i qëndroi pranë deri në momentet e fundit të jetës dhe vijoi veprimtarinë në shërbim të vendit në vitet e mëvonshme.